

GJYKATA E QARKUT NE MITROVICE

P. Nr. 11/2011

27 Mars 2012

NE EMER TE POPULLIT

GJYKTA E QARKUT NE MITROVICE, ne Trupin Gjykses te përbëre nga Gjyqtarja e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati, Kryetare e Trupit Gjykses, Gjyqtari Beqir Halili dhe Gjyqtarja e EULEX-it Roxana Comsa, Anëtare e Trupit Gjykses, me pjesëmarrjen e Këshilltarit Ligjor te EULEX-it Kabil Merovci, procesmbajtës, ne lenden penale kundër:

REMZI HASANAJ, i akuzuar me Vrasje sipas nenit 146 te KPK, **Mbajtje ne Pronësi, Kontrolle, Posedim apo Përdorim te Pa-autorizuar te armeve** sipas nenit 328 Paragrafi 1 te KPK dhe Mbajtje ne Pronësi, Kontrolle, Posedim apo Përdorim te Pa-autorizuar te armeve sipas Nenit 328 Par 2 te KPK, sipas Aktakuzës se Prokurorit Publik te Qarkut PP Nr.146/10, e datuar dhe e parashtruar me 15 Shkurt 2011.

Pas mbajtjes se Shqyrtimit Kryesor te hapur për publik me 21, 22, 23 Shkurt, me 02, 12, 16, 22, 23 dhe 26 Mars 2012, ne prezence te te akuzuarit Remzi Hasanaj, Avokatit Mbrojtës te tij, Mahmut Halimi (me përjashtim te seancës se datës 12 Mars 2012, kur ai eshte zavendesuar nga Avokati Mbrojtës Betim Shala), Prokurorja Publike e EULEX-it Neeta Amin dhe Pales se Demtuar Zeqir Durmishi, përfaqësues i familjes se viktimës Musa Durmishi;

Pas pleqnimit dhe votimit te Trupit Gjykses te mbajtur me 26 Mars 2012, sipas Nenit 392 par.1 te Kodit te Procedurës Penale te Kosoves (KPPK) me 27 Mars 2012, shpalle publikisht dhe ne prezence te Akuzuarit, Avokatit te tij Mbrojtës, Prokurorit Publik te EULEX-it dhe Palës se Dëmtuar, këtë

AKTGJYKIM

I Akuzuari **REMZI HASANAJ**, emri i babës Kadri, emri i nënës Hanife, mbiemri i vajzërisë Hoti, i lindur me 26.06.1938 ne fshatin Kllodernice, Komuna e Skenderaj, i pensionuar, me vendbanim ne rrugën “Dëshmorët e Kombit” ne Shipol te Komunës se Mitrovicës, Kosovar Shqiptar, babe i shtate fëmijëve te rritur, i gjendjes se mesme ekonomike, ne paraburgim nga data 22.11.2010 deri me 11.11.2011 e nga ajo kohe ne arrest shtëpiak,

shpallet

FAJTOR



Sepse me 18 Nentor 2010 rreth orës 10:45 ne vendin e quajtur Ura e Gjakut ne Mitrovice, ai qëllimisht e ka privuar nga jeta Musa Durmishin duke e sulmuar atë me thike dhe duke e therre atë me thike tete here ne pjese te ndryshme te trupit te tij, ne zonën rreth gjoksit, ne zonën e zemrës, duke i shkaktuar atij lëndime serioze trupore. Si rezultat i këtyre lëndimeve Musa Durmishi ka vdekur gjate rrugës për ne klinike ne Mitrovice.

Me një veprim te tille, Remzi Hasanaj ka kryer dhe eshte penalisht pergjegjes për veprën penale te Vrasjes ne shkelje te Nenit 146 te KPK- (Akuza 1)

I Akuzuari Remzi Hasaj gjithashtu

shpallet

FAJTOR

Sepse rreth viteve 1990 dhe 24 Gusht 2010, ne shtëpinë e tij ne rrugën Dëshmorët e Kombit ne fshatin Shipol te Komunës se Mitrovicës, ai ka qene ne pronësi te armës-një pistolete TT M57 me numër serik C-22309, te kalibrit 7.62 mm-pa kartelev te vlefshme te autorizuar.

Me një veprim te tille, Remzi Hasanaj ka kryer dhe eshte penalisht pergjegjes për veprën penale **Mbajtje ne Pronësi, Kontrolle, Posedim apo Përdorim te Pa-autorizuar te armeve ne shkelje te Nenit 328 Paragrafi (2) te KPK- (Akuza 3)**

I Akuzuari Remzi Hasanaj

Shpallet


I PAFAJSHËM

Sepse nuk eshte vërtetuar se me 24 Gusht 2010 ne shtëpinë e tij Dëshmoret e Kombit ne fshatin Shipol te Komunës se Mitrovicës, ai ka shtëne ne ajër me rafalë te armës automatike për te frikësuar dhe kërcënuar fqinun e tij, Musa Durmishi.

Prandaj, sipas Nenit 390, Pika 3 e KPPK, ai lirohet nga akuza e **Mbajtje ne Pronësi, Kontrolle, Posedim apo Përdorim te Pa-autorizuar te armeve ne shkelje te Nenit 328 Paragrafi (1) i KPK- (Akuza 2)**

PRANDAJ, I akuzuari **Remzi HASANAJ**

DENOHET



Me

-8 /tete/ vjet burg për veprën penale të **Vrasjes** /Akuza 1/

-2 /dy/ vjet burg për veprën penale **Mbajtje në Pronësi, Kontrollë, Posedim apo Përdorim të Pa-autorizuar të armeve** /Akuza 3/

Dënimi i përbashkët përcaktohet me 9 /nënte/ vjet burg sipas Nenit 71 Paragrafi 1 dhe 2, Pika 2 e KPK.

Koha e kaluar në paraburgim ndërmjet 22 Nentor 2010 dhe 11 Nentor 2011 si dhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 11 Nentor 2011 deri në ditën e shpalljes së Aktgjykimit do të numërohen sipas Nenit 73, Paragrafi 1 dhe 4 të KPK.

Arma- pistoletë TT M57 me numër serik C-22309, të kalibrit 7.62 mm- me këtë rast konfiskohet sipas Nenit 60, Paragrafi 1 dhe Neni 328, Paragrafi 5 të KPK.

I akuzuari do të paguaj 400 (katërqind) EURO si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale por ai lirohet nga detyra e pagesës së shpenzimeve tjera sipas Nenit 102, Paragrafi 1 dhe 4 të KPPK.

Procesmbajtës:

Kabil Merovci
/Nënshkrimi/



Kryetari i Trupit Gjykes:

Hajnalka Veronika Karpati
/Nënshkrimi/